



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.191/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarëve ligjorë Edona Grajçevci, duke vendosur përkitazi me ankesën e Rrjeti Balkanik Hulumtues për Gazetari (BIRN) dhe Inter News Kosova, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Euroatlantike e Kosovës, me seli në Prishtinë, për shkak të përdorimit të fëmijëve në fushatë zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 04.10.2019, mori këtë:

#### V E N D I M

**REFUZOHET** e pabazuar ankesa Anr.191/2019 e datës 02.10.2019, e paraqitur nga Rrjeti Balkanik Hulumtues për Gazetari (BIRN) dhe Inter News Kosova, me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Partia Euroatlantike e Kosovës, me seli në Prishtinë.

#### A r s y e t i m

Organizata BIRN me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë në PZAP më datë 02.10.2019, me të cilën pretendon se me datën 02 tetor 2019 rreth orës 10:50 kanë vërejtur se kandidati për kryeministër i Partisë Euroatlantike të Kosovës Milaim Zeka, në rrjetin e tij social në Facebook, më datë 30 shtator 2019, ka shpërndarë një fotografi me fëmijë duke shënuar "Fitorja është e garantuar Amelia dhe Adea". Paraqitësi i ankesës pretendon se përdorimi i fëmijëve në fushatë është i ndaluar me rregulloren 13/2013 e plotësuar me rregulloren 20/2019 për fushatën e zgjedhjeve dhe njoftimi për ngjarjet, përkatësisht nënin 5 paragrafi 3 pika d). Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur disa fotografi lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 03.10.2019, subjekti politik Partia Euroatlantike e Kosovës, thekson se fjala është për statusin personal në rrjetin social facebook të kandidatit për kryeministër Milaim Zeka, me tutje theksojnë se nuk kishte për qëllim fushatën zgjedhore dhe z. Zekaj nuk ishte në dijeni se postimi me fëmijët e tij përbën shkelje dhe ka marr veprim duke larguar foton nga rrjeti social facebook.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se: **Ankesa është e pabazuar**

PZAP-i, vendimet e tij i bazon në dëshmi qarta dhe bindëse siç është përcaktuar me nenin 117 paragrafi 3 i LZP-së, e që në rastin konkret fotografia që gjendet në shkresat e lëndës identifikohet se fëmijët nuk janë duke e promovuar subjektin politik Partin Euroatlantike të Kosovës, siç pretendohet nga ankuesi. Andaj, pretendimet ankimore të ankuesit së është

bërë shkelja e Rregullës 13/2013 e plotësuar me rregulloren zgjedhore 20/2019, për fushatën e zgjedhjeve, përkatësisht nenin 5 paragrafi 3 pika d), nga ana e subjektit politik PEK, janë të pa qëndrueshme dhe pa bazë ligjore, për faktin se, veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të rregullës zgjedhore 02/2019, për ndryshimin dhe plotësimin e rregullës zgjedhore Nr. 13/2013.

Nga arsyet e theksuar me lart e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, neni 117 paragrafi 3 neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me nenin 8 paragrafi 4 i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.191/2019 më datën 04.10.2019

**Kryesuesi i Panelit**

Faton Ademi



**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*